



SUBVENCIONE PËR NDËRMARRËSI PËR VITIN 2018 - RAPORTI FINAL

Projektin për mbështetje të zhvillimit të sektorit privat në komunën e Preshevës e ka zbatuar komuna e Preshevës në bashkëpunim me agjencionin e akredituar për zhvillim regional nga Leskovci, Qendrën për zhvillim të Rrethit të Jabllanicës dhe Pçinjës. Mjetet për realizimin e këtij projektit janë të përcaktuara sipas vendimit të buxhetit programorë të Komunës së Preshevës për vitin 2018, në Programin 1501-0003, funksioni 411, numri rendrorë 49, klasifikimi ekonomik 454 në shumë prej **10.000.000 dinarë**.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është avancimi i zhvillimit të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe ndërmarrësisë në përgjithësi, rritjen e volumit të shitjes, avancimin e eksportit, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Projekti është zhvilluar në dy faza:



Faza I - Aplikimi për pjesëmarrje në trajnim për fillimin/avancimin e biznesit

Faza II - Aplikimi për mjete të pakthyeshme në sferën e ndërmarrësisë


FAZA E PARË

Në thirrjen e hapur për aplikacione për pjesëmarrje në trajnim për fillimin/avancimin e biznesit dhe ndarjen e mjeteve të pakthyeshme në sferën e ndërmarrësisë, në kuadër të projektit për mbështetje të zhvillimit të sektorit privat në Komunën e Preshevës për vitin 2018, gjithsej i kemi pranuar 116 aplikacione.

Prej 116 aplikuesve, 76 (66%) aplikues hynë në kategorinë e bizneseve egzistuese dhe 40 (34%) aplikues aplikojnë për biznese të reja. Në bazë të vlerësimit të komisionit, prej **116 aplikacioneve, 80 (69%)** aplikues kalojnë për në fazën e parë të trajnimeve.



Në kategorinë e atyre që kalojnë në fazën e parë për trajnim **51 (63%)** aplikues janë biznese egzistuese, ndersa **29 (37%)** aplikues janë biznese të reja.




Me qëllim të aftësimit të aplikuesve në përpilimin e aplikacioneve sa më kualitative, komuna e Preshevës ka organizuar trajnim 4 ditorë për fillimin/avancimin e biznesit që është përbërë prej dy moduleve, siç janë: 1) Trajnimi për fillestarë në ndërmarrësi dhe përgaditja e biznes planit, si dhe 2) Bashkëpunimi me bankat.


Trajnimi është mbajtur gjatë datave 18,19, 25, dhe 26 Qershor 2018 dhe është ofruar nga agjencioni i akredituar për zhvillim regional nga Leskovci, Qendra për zhvillim të Rrethit të Jabllanicës dhe Pçinjës. Afati për paraqitjen e aplikacionit në kuadër të fazës së dytë të Programit (Biznes Planit) ka qenë i kushtëzuar me realizimin e trajnimeve për fillimin/avancimin e biznesit, gjegjësisht 14 ditë pas kryerjes së trajnimeve (10.07.2018 afati i fundit për aplikim).

FAZA E DYTË

Nga 80 aplikues gjithësejt që kanë kaluar fazën e parë dhe kanë fituar të drejtën për trajnim dhe pastaj për të aplikuar për mjete të pakthyshme, 67 prej tyre kanë dorëzuar biznes planin. Nga 67 aplikues, 45 (69%) aplikues hynë në kategorinë e bizneseve ekzistuese dhe 22 (31%) aplikues aplikojnë për biznese të reja. Në kategorinë e atyre që kalojnë në fazën e dytë dhe fitojnë të drejtën për të shfrytëzuar mjetet e pakthyeshme, në bazë të vlerësimit të komisionit prej **67 aplikacioneve, 48 (72%)** aplikuesve iu janë aprovuar mjetet e pakthyeshme jofinanciare.



Në kategorinë e atyre që iu janë aprovuar mjetet e pakthyeshe jofinanciare, **31 (67%)** aplikues janë biznese ekzistuese, ndersa **17 (33%)** aplikues janë biznese të reja.



Në evaluimin e aplikacioneve Komisioni ka qenë në përbërje më të gjerë ku përveç tre përfaqësuesve të Komunës së Preshevës kanë marrë pjesë edhe dy përfaqësues me përvojë afatgjate të Qendrës për zhvillim të Rrethit të Jabllanicës dhe Pçinjës nga Leskovci. Angazhimi i përfaqësuesve të agjencionit për zhvillim është bërë me qëllim të ngritjes së nivelit të objektivitetit gjatë procesit të vlerësimit të aplikacioneve. Vlerësimi është bërë në bazë të notimit, mënyrë e cila është e aprovuar nga Agjencioni për zhvillimin e Sërbise. Sa i përket shpërndarjes së mjeteve, plani nënkupton:



1. Lajmerimin e përfituesve;
2. Nënshkrimi i kontratave;
3. Eventi publik për shpërndarjen e kontratave dhe mirënjohjeve;
4. Periudha e implementimit (bëhet në bazë individuale për secilin përfitues);
5. Monitorimi dhe Mentorimi nga CRJP dhe ZzhEL;
6. Raporti final mbi implementimin e projektit (Raporti do t'i dorzohet këshillit komunal mbas implementimit, mbas një viti).

Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal

Komuna e Preshevës